

Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draft aktit

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, i ndryshuar””.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Ky projektligj është hartuar nga grupi i punës, i ngritur me urdhër të ministrit të Brendshëm nr. 26, datë **21.02.2022**.

Ky projektligj është konsultuar në mbledhjet e grupit të punës, përkatësisht në datat 25.02.2022, 02.03.2022 dhe 08.03.2022. Në datën 31.05.2022, u zhvillua tryeza e konsultimit publik.

Konsultimi publik zgjati 1 muaj, nëpërmjet publikimit në RENJK, nga data 10 maj 2022 deri më **7 qershor 2022**, në përputhje me afatin që parashikon ligji.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, i ndryshuar””, ishin tre:

1. Konsultimi elektronik, përmes Regjistrisë Elektronike për Njoftimet dhe Konsultimet, (RENJK), në të cilin ka pasur 429 vizita, por pa komente;
2. Posta elektronike;
3. Tryezë konsultimi publik, për të cilë është bërë njoftimi në RENJK dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Brendshme.

4. Palët e interesit të përfshira

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike gjatë procesit të hartimit, janë:

- Grupi i punës i ngritur me urdhër të ministrit të Brendshëm nr.26 datë 21.02.2022;
- Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI);
- Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit;
- Drejtorja e Politikave dhe Strategjive në Ministrinë e Brendshme (MB);
- Drejtorja e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në MB;
- Drejtorja Juridike, Drejtorja e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Drejtorja e Burimeve Njerëzore (Sektori i Trajnimeve) në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSH);
- Sektori i Informimit të Brendshëm etj., në Gardën e Republikës;
- Drejtorja e Inspektimit dhe Ankesave, Drejtorja e Vlerësimit Kalimtar e Periodik etj., në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore (AMP).

Ministria e Brendshme (MB) organizoi një tryezë konsultimi publik në datë 31.05.2022, ora 10:00, në lidhje me ndryshimet dhe efektet që do të sjellë projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, i ndryshuar”.

Takimi konsultativ u zhvillua në ambjentet e MB dhe u drejtua nga Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Brendshme. Në të morën pjesë përfaqësues edhe nga institucionet subjekte të ligjit dhe jo vetëm, përkatësisht:

- 2 përfaqësues të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit (KJV (Kryetar & Anëtar)
- 3 përfaqësues të Ministrisë së Brendshme (Përgjegjës sektori & Specialistë)
- 3 përfaqësues të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore (Drejtore i Përgjithshëm & Drejtore)
- 2 përfaqësues të Policisë së Shtetit (DPPSH) (Drejtore)
- 1 përfaqësues i Gardës së Republikës (Përgjegjës Sektori)
- 1 përfaqësues i ICITAP
- Përfaqësuesi i Delegacionit të Bashkimit Evropian ishte ftuar, por nuk pati paraqitje.

Për sa më lart, rezultoi se në takim nuk morën pjesë përfaqësues të shoqërisë civile, organizata, shoqata etj.

• Kryetarja e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, parashtroi këto komente:

1. Të rishikohet parashikimi i bërë në nenin 17 të projektligjit si vijon: “Nenet 29 dhe 30 shfuqizohen”, me qëllim që të mos hiqet parashikimi i bërë në pikën 3 të nenit 29 si vijon: “Në përfundim të procesit të vlerësimit, anëtarët e komisionit të jashtëm të Vlerësimit kthehen në vendet e tyre të punës, ose me pëlqimin e tyre, në vende të barasvlefshme”.

Ky koment është reflektuar dhe në draftin e dërguar për bashkërendim, neni 17 ka ndryshuar si vijon: “Neni 30 shfuqizohet”.

2. Të rishikohet parashikimi i bërë në nenin 51 të projektligjit: *Neni 68 ndryshohet si më poshtë vijon: Neni 68(Dispozitë kalimtare)*

1. “Veprimtaria e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit përfundon me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

2. Formularët e deklarimeve të plotësuar më parë, administrohen nga strukturat përgjegjëse të burimeve njerëzore të çdo institucioni”.

Përfaqësuesja e KJV argumentoi se parashikimi i pikës 1 të nenit 68, është i pamjaftueshëm për dorëzimin e informacionit, prandaj duhet të:

- 1) Përcaktohet një metodikë e qartë pune për dorëzimin e të gjithë dokumentacionit që ka Komisioni, pasi punohet edhe me dosje të klasifikuara;
- 2) të vendoset një hark kohor i mjaftueshëm për KJV që do të bëjë dorëzimin e dokumentacionit dhe gjithashtu për institucionin që do t’i marrë në dorëzim dosjet (me qëllim shmangien e rrjedhjes së informacionit apo gabimeve në dorëzim).

U diskutua mundësia që në dispozitën kalimtare të përcaktohet metodika e dorëzimit të këtyre dokumentave, mbase specifikuar me një akt tjetër nënligjor (udhëzim ministri etj). Gjithashtu, sikurse dispozita që përcakton përfundimin e KJV, propozohet përcaktimi i një periudhe tjetër mandati përfundimtar brenda një periudhe kohe të caktuar nga hyrja në fuqi e këtij ligji, periudhë gjatë të cilës të jetë dorëzuar i gjithë dokumentacioni.

Komentet u pranuan, dhe në procesin e bashkërendimit neni 51, ndryshoi si vijon:

Neni 68 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 68

Dispozitë kalimtare

1. Veprimtaria e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit përfundon brenda 3 muajve me hyrjen në fuqi të këtij ligji, kohë e cila do shërbejë për dorëzimin e detyrës dhe kalimin e kompetencave pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
2. Personeli i Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit që do merret me procesin e dorëzimit të detyrës nuk do jetë më shumë se 6 punonjës.
3. Dokumentacioni dhe vendimet që janë marrë nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit për subjektet që ka vlerësuar ky komision, do të dorëzohen pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
4. Punonjësit që kanë kaluar më parë vlerësimin kalimtar nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, sipas këtij ligji, nuk janë subjekte të vlerësimit kalimtar, vetëm të atij periodik.
5. Formularët e deklarimeve të plotësuar më parë, si dhe dokumentacioni i administruar në Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit për subjektet që nuk ka një vendim përfundimtar, do dorëzohen dhe arkivohen në strukturat përgjegjëse të burimeve njerëzore të çdo institucioni dhe do tërhiqen nga çdo subjekt respektiv”.

• Një nga përfaqësuesit e Policisë së Shtetit, parashtroi këto komente:

- 1) Për mos shfuqizimin e parashikimit të përcaktuar në nenin 21, konkretisht për nenin 34, në të cilin bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijojnë:
 4. *Shfuqizohet pika 4 e nenit 34;*
 5. *Në shkronjën “b” të pikës 6, hiqet togfjalëshi “kur rezulton se ka deklaruar më shumë se dyfishin e pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të”.*
- 2) Dhe krahas tij propozoi parashikimin e përcaktimit të vitit 2012 si periudhë nga e cila subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, edhe për shkak të afateve të ruajtjes së dokumentacionit para se të arkivohen.

Komentet nuk u reflektuan, pasi në projektligj është parashikuar se subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të, ka detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive nga viti 2008 dhe në vijim. Kjo sepse, rezulton se i vetmi element që mund të formalizojë të ardhurat nga subjektet, është të provuarit përmes sistemit bankar dhe marrja e këtij informacioni është i mundur lehtësisht për periudhën 2005 e në vijim.

Për sa më lart, pika 4 e nenit 34 (Procedura e vlerësimit të pasurisë) të ligjit, parashikonte se:

4. Trupa e vlerësimit ose Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, për vlerësimin e pasurive të deklaruara nga punonjësi, mund të kryejë verifikime në terren.

Ndërsa shkronja “b”, pika 6 parashikonte se:

6. “Në përfundim të procedurës së kontrollit të pasurisë, trupa e vlerësimit ose Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, bazuar në të dhënat që ka mbledhur, përgatit një raport të hollësishëm e të arsyetuar dhe, sipas rastit, konstaton se:

b) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, kur rezulton se ka deklaruar më shumë se dyfishin e pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të”.

Si përfundim, në draftin final të projektligjit u parashikua në nenin 21, që të bëhen në nenin 34, shtesat dhe ndryshimet si vijojnë:

4. “Shfuqizohet pika 4 e nenit 34;

5. Në shkronjën “b” të pikës 6, hiqet togfjalëshi “kur rezulton se ka deklaruar më shumë se dyfishin e pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të”.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar <i>(psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i>	Komente <i>(grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</i>	Palët e interesuara <i>(renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i>	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Shkurtimi “ILDPKI” në “ILDKPKI”	Zëvendësimi i shkurtimit “ILDPKI” me akronimin “ILDKPKI” në tekstin e projektligjit	ILDKPKI	Pranuar	Ndryshim i nevojshëm
Në lidhje me nenin 6 pika 2 mbi formularët e deklarimit të miratuara me udhëzim të Ministrit të Brendshëm, dhe Inspektorit të Përgjithshëm të ILDPKI	<p>Formularët e deklarimit duhet të miratohen me akt nënligjor në formën e “urdhrit” të ministrit të Brendshëm, si institucion që ka në varësi të drejtpërdrejtë Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, e ngarkuar për kryerjen e vlerësimit kalimtar dhe periodik të subjekteve të këtij projekt-ligji.</p> <p>Udhëzimi në formën e një akti nënligjor përcakton rregullat, apo procedurat që duhet të ndiqen me qëllim plotësimin e formularit të deklarimit, i cili në formë dhe përmbajtje miratohet me urdhër.</p> <p>Gjithashtu, miratimi i formularëve të deklarimit për procesin e vlerësimit kalimtar dhe periodik nuk mund të miratohen së bashku nga ministri i Brendshëm dhe ILDKPKI, për aq sa ky i</p>	ILDKPKI	I pranuar pjesërisht	Sa i përket formularëve të deklarimit për kriterin pasuror gjykojmë që duhet të miratohen me urdhër të përbashkët të ministrit të Brendshëm dhe Inspektorit të Përgjithshëm, pasi ILDKPKI do të ketë rol aktiv në vlerësimin e këtij kriteri dhe elementi thelbësor i vlerësimit është formulari i deklarimit, që ka të bëjë me mënyrën e plotësimit, llojin e të dhënave që do të pasqyrohen, si dhe rubrikat e domosdoshme, me qëllim kryqëzimin me gjetjet e korespondencat e institucioneve.

	fundit nuk është përgjegjës, por vetëm ndihmës i trupave të vlerësimit të parashikuar nga projekt-ligji.			
Në lidhje me nenin 32 “Fillimi i procedurës për deklarimin e pasurisë”	-Të bëhet zëvendësimi i “punonjës” me termin “subjekt vlerësimi”, për aq sa në nenin 3 të projekt-ligjit ky term përfshin punonjësit që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit. -Shprehja “moment i fillimit të punës” duhet të zëvendësohet me “datën e fillimit të punës” për aq sa është lehtësisht e përcaktueshme në urdhrin e fillimit të marrëdhënieve të punësimit.	ILDKPKI	Pranuar	Janë reflektuar sugjerimet, me qëllim unifikimin e termave të përdorur
Në lidhje me nenin 32 (pika 2) “Fillimi i procedurës për deklarimin e pasurisë”	Duhet të ndryshohet duke u hequr kufizimi “nga viti 2008 dhe në vijim” për aq sa bie në kundërshtim me vetë objektin e vlerësimit të pasurisë, i cili kërkon ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të deklaruar në formularin e deklarimit. Vendosja e kufizimit kohor nuk mundëson kryerjen e një kontrolli të plotë në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, duke penguar hetimin e ligjshmërisë të pasurive të krijuara përpara vitit 2008. Nëse një pasuri është krijuar në vitin 2007, subjekti përjashtohet nga detyrimi për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, çka është në kundërshtim me vet objektin e vlerësimit të pasurisë, i cili kërkon vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave që përmbahen	ILDKPKI	Refuzuar	-Në lidhje me këtë sugjerim për të hequr kufizimin “nga viti 2008 dhe në vijim”, në pikën 2 të nenit 32, grupi hartues i punës, pas një analize të thellë dhe të arsyetuar ka gjykuar si të domosdoshme rikonceptimin e procesit të vlerësimit të pasurisë, duke përcaktuar deklarimin e subjektit pa afat kohor, ndërsa periudhën e vlerësimit nga viti 2008 dhe në vijim, pasi kjo periudhë përkon me formalizimin e ekonomisë, parashikimin e legjislacionit në fuqi për ruajtjen/arkivimin e dokumentacionit nga institucionet publike, si dhe të dhënave sistematike të INSTAT, duke mundësuar kështu lehtësi në aksesimin e të gjitha dokumentave që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive. -Në analizë janë trajtuar dhe vendimarrjet dhe ecuria e procesit nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, i cili ka hasur vështirësi mjaft serioze për mbledhjen e dokumentacionit, duke passjellë vendimarrje të paqarta interpretative dhe standarde ndryshe, kjo thjesht dhe vetëm nga mos kufizimi

	<p>në deklaratën e pasurisë dhe interesave privatë, burimit financiar të krijimit të pasurive dhe ligjshmërinë e tij.</p> <p>Për më tepër, ILDKPKI, në përmbushje të detyrimeve funksionale dhe kompetencave ligjore, në praktikën e gjatë 19 vjeçare, kryen kontrollin e pasurisë së subjekteve deklarues, bazuar në ligjin “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive...”, dhe të akteve nenligjore të dala në zbatim të tij, që kërkon një hetim të plotë mbi ligjshmërinë e pasurive të deklaruara.</p> <p>Kështu, ILDKPKI ka pasur praktika të suksesshme me procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, si dhe me kandidatët për institucionet e ndryshme të sistemit të drejtësisë, të cilët për këto procese të rëndësishme kanë plotësuar deklaratat për kandidatë dhe i janë nënshtruar procedurave të kontrollit.</p> <p>Në përfundim ILDKPKI ka kryer kontroll të plotë gjithëpërfshirës duke analizuar pasurinë dhe ligjshmërinë e burimeve financiare që kanë shërbyer për krijimin e saj dhe jo duke e ndarë në periudha kohore.</p>			<p>i afatit kohor dhe mungesa e dokumentacionit justifikues.</p> <p>Arsyetojmë gjithashtu që kufizimi kohor, nuk nuk bie ndesh me ligjin organik të ILDKPKI-së, pasi nuk është elementi kohë që cënon standardin, por metodologjia, procedura dhe vendimarrja, që në këtë projekt ligj janë të njëjta. Ligji 12/2018 përkatësisht nenet 32, 33, 34 janë të sinkronizuara me ligjin nr.9049, dt.10.04.2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare...”, nenet 4, 4/1, 4/2, 21, 22, 25, 26 dhe në vijim, madje dhe me ligjin për rivlerësimin e prokurorë/gjyqtarëve, ku ILDKPKI-së ka të njëjtin rol, që duam ti japim me këtë projekt ligj, pa asnjë ndryshim.</p> <p>-Duke vlerësuar eksperiencën e ILDKPKI, lidhur me praktikën e suksesshme për rivlerësimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve, por theksojmë se inicimi dhe fryma e këtij ligji, nuk është e barasvlefshme me ligjin e rivlerësimit kalimtar të prokurorë/gjyqtarëve, pasi dhe interesi publik, është proporcionalisht më i madh për këta të fundit, në kuadër të reformës në drejtësi. Ligji 12/2018, është një ligj me efekt të përkohëshëm, i cili nuk ka qëllim primar ndëshkimin e funksionarëve të policisë, por identifikimin e pjesës së shëndoshë dhe me integritet të cilët duhet të vlerësohen gjatë ecurisë në karrierë.</p> <p>-Si përfundim, për ta mbyllur arsyetimin e vendosjes së afatit kohor. I gjithë ky proces, lidhur me vlerësimin pasuror, do definojë në vendimarrje, dhe nuk do jetë deklarativ, për rrjedhojë, vendosja një afati të përcaktuar formalizues, të drejtë dhe objektiv, do garantojë procesin e rregullt ligjor, respektimin kontradiktoritetit, dhe garantimin e të drejtave të subjekteve.</p>
Në lidhje me nenin 32 (pika 3) “Fillimi	Pika 3, duhet të ndryshohet në përputhje	ILDKPKI	Pranuar	I nevojshëm me qëllim përputhjen me nenin 6, pika 2

<p><i>i procedurës për deklarimin e pasurisë</i></p>	<p>me rekomandimin e dhënë për nenin 6 pika 2, si në formën e aktit nënligjor me anë të të cilit duhet të miratohet formulari i deklarimit, ashtu dhe me institucionin përgjegjës që duhet të nxjerrë këtë akt.</p>			
<p>Në lidhje me nenin 32 (pika 6) <i>“Fillimi i procedurës për deklarimin e pasurisë”</i></p>	<p>Pika 6, duhet të hiqen termat “mundet” për aq sa paraqitja e dokumentave justifikues për vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve janë të domosdoshme dhe thelbësore për fillimin dhe ecurinë e procesit të vlerësimit të pasurisë.</p>	<p>ILDKPKI</p>	<p>Pranuar</p>	<p>Reflektuar</p>
<p>Në lidhje me nenin 17, mbi shfuqizimin e neneve 29 dhe 30</p>	<p>Të rishikohet parashikimi i bërë në nenin 17 të projektligjit si vijon: <i>“Nenet 29 dhe 30 shfuqizohen”</i>, me qëllim që të mos hiqet parashikimi i bërë në pikën 3 të nenit 29 si vijon: <i>“Në përfundim të procesit të vlerësimit, anëtarët e komisionit të jashtëm të Vlerësimit kthehen në vendet e tyre të punës, ose me pëlqimin e tyre, në vende të barasvlefshme”</i>.</p>	<p>Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit</p>	<p>I pranuar</p>	<p>I nevojshëm</p>
<p>Mbi dorëzimin e dokumentacionit të Komisionit</p>	<p>Përcaktohet një metodikë e qartë pune për dorëzimin e të gjithë dokumentacionit që ka Komisioni, pasi punohet edhe me dosje të klasifikuara; dhe të vendoset një hark kohor i mjaftueshëm për KJV që do të bëjë dorëzimin e dokumentacionit dhe gjithashtu për</p>	<p>Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit</p>	<p>I pranuar</p>	<p>I nevojshëm</p>

	institucionin që do t'i marrë në dorëzim dosjet (me qëllim shmangien e rrjedhjes së informacionit apo gabimeve në dorëzim).			
Mbi mos shfuqizimin e parashikimit të përcaktuar në nenin 21	Konkretisht për nenin 34, në të cilin bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijojnë: <i>4. Shfuqizohet pika 4 e nenit 34;</i> <i>5. Në shkronjën "b" të pikës 6, hiqet togfjalëshi "kur rezulton se ka deklaruar më shumë se dyfishin e pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të".</i>	DPPSH (një nga përfaqësuesit)	I refuzuar	Parashikimi është konsultuar me institucionet përgjegjëse në këtë fushë.
Mbi parashikimin e një periudhe tjetër për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive	Propozoi parashikimin e përcaktimit të vitit 2012 si periudhë nga e cila subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, edhe për shkak të afateve të ruajtjes së dokumentacionit para se të arkivohen.	DPPSH (një nga përfaqësuesit)	I refuzuar	Rezulton se i vetmi element që mund të formalizojë të ardhurat nga subjektet, është të provuarit përmes sistemit bankar dhe marrja e këtij informacioni është i mundur lehtësisht për periudhën 2005 e në vijim.